

ANKESË

NJOFTIM I RËNDËSISHËM: Ankesa të cilën na e dërgoni do të kopjohet dhe do t'i dërgohet personit fizik dhe/ose juridik, përkatësisht organit kundër të cilit e paraqisni ankesën.

TË DHËNAT PERSONALE PËR PARAQITËSIN E ANKESËS

1. EMRI: _____
2. MBIEMRI: _____
3. EMËRTIMI _____

(nëse paraqitësi i ankesës është person juridik)

4. A E PARAQISNI ANKESËN PËR NDONJË PERSON TJETËR? _____ (përgjigjuni me PO ose JO)
5. NËSE PËRGJIGJJA PËR PYETJEN E MËPARSHME ËSHTË POZITIVE, SHKRUANE NË EMËR TË KUJT PO E PARAQISNI ANKESËN: _____

6. A E KENI PËLQIMIN E PERSONIT NË EMËR TË TË CILIT PO E PARAQISNI ANKESËN: _____
- (përgjigjuni me PO ose JO dhe patjetër bashkëlidhne pëlqimin, nëse e keni)
7. ADRESA/SELIA: _____

8. TELEFONI: _____
 9. E-mail: _____
 10. DATA E LINDJES: _____
- (nuk është e obligueshme kjo e dhënë)

TË DHËNAT PËR PERSONIN JURIDIK DHE/OSE FIZIK, PËRKATËSISHT ORGANIN KUNDËR TË CILIT E PARAQISNI ANKESËN

A) NËSE ANKESA KA TË BËJË ME PERSONIN JURIDIK/ORGANIT

1. EMËRTIMI I PERSONIT JURIDIK/ORGANIT _____

2. SELIA DHE ADRESA _____

3. TELEFONI _____
4. A JENI I PUNËSUAR TE KY PERSON JURIDIK? _____ (përgjigjuni me PO ose JO)

B) NËSE ANKESA KA TË BËJË ME PERSONIN FIZIK

1. EMRI DHE MBIEMRI _____

2. ADRESA _____

3. TELEFONI _____

4. PERSONI PËR TË CILIN POHONI SE JU KA DISKRIMINUAR A E KA BËRË KËTË NË VEND TË VET TË PUNËS/DUKE I KRYER DETYRAT E PUNËS _____

(përgjigjuni me PO ose JO)

5. NËSE PËRGJIGJJA PËR PYETJEN E MËPARSHME ËSHTË POZITIVE, THEKSONI KU ËSHTË I PUNËSUAR AL PERSON _____

(emërtimi i ndërmarrjes/institucionit/organizatës, adresën, telefonin, pozitën/vendin e punës së atij personi)
SHËNIM: Nëse ka më shumë persona juridikë dhe/ose fizikë, përkatësisht organe ndaj të cilave e paraqisni ankesën, ju lutemi që për secilin veçanërisht plotësojeni formularin e ankesës.

BAZA E DISKRIMINIMIT

Rrethojeni një ose më shumë baza (veçori personale) në bazë të të cilave konsideroni se keni qenë të diskriminuar.

1. Raca
2. ngjyra e lëkurës
3. paraardhësit
4. shtetësia
5. përkatësia kombëtare ose origjina etnike
6. gjuha
7. bindja fetare ose politike
8. gjinia
9. identiteti gjinor
10. orientimi seksual
11. gjendja pronësore
12. lindja
13. veçoritë gjenetike
14. gjendja shëndetësore
15. invaliditeti
16. statusi martesor dhe familjar
17. gjendja gjyqësore
18. grup-mosha
19. pamja
20. anëtarësimi në organizata politike, sindikale ose në organizata të tjera

Si t'i drejtoheni Komisarit për mbrojtjen e barazisë?

Secili që konsideron se është i diskriminuar mund t'i paraqesë ankesë Komisarit për mbrojtjen e barazisë.

Ankesa i paraqitet në formën me shkrim në formularin e dhënë, të cilin mund ta merrni edhe nga web faqja zyrtare www.ravnopravnost.gov.rs

Ankesa duhet t'i përmbajë të dhënat kush është viktimë e diskriminimit, kush ka bërë diskriminim, përshkrimin e procedurës diskriminuese, si edhe dëshmitë për diskriminimin e pësuar (dokumentet, dëshmitarët etj.)

Ankesa duhet të jetë e nënshkruar. Komisari nuk vepron sipas ankesës anonime.

Procedura para Komisarit për mbrojtjen e barazisë është falas dhe zgjat 90 ditë.

Komesari nuk mundet t'i dënoje diskriminuesit nëse nuk i respektojnë rekomandimet e tij, por mund t'i bindë që këtë ta bëjnë për shkak të autoritetit të institucionit, me forcën e argumenteve dhe me presion të opionionit.



Ky projekt është mbështetur financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë Norvegjeze në Beograd.



POVERENIK ZA
ZAŠTITU
RAVNOPRAVNOSTI

Çfarë është diskriminimi?

Diskriminimi është kur një person është lënë në pozitë më të keqe në krahasim me të tjerët, dhe kur shkak për këtë është ndonjë veçori e tij ose e saj personale.

SHEMBULL: në ndonjë shpallje për vend pune për profesor të djuhës angleze që mund ta kryejë secili person që e ka mbaruar Fakultetin Filogjik, kërkohet ndonjë person i cili nuk është më i moshuar se 30 vjeç, me çfarë përjashtohen të gjithë personat që kanë më shumë se 30 vjet – ky është rast kur ndaj të barabartëve nuk veprohet në mënyrë të barabartë.

Diskriminimi mund të shkaktohet edhe kur ndaj një personi (ose grupi) veprohet ashtu siç veprohet edhe ndaj të tjerëve, edhe pse ata, për shkak të ndonjë veçorie personale, gjenden në pozita të ndryshme në krahasim me të tjerët.

SHEMBULL: Kur kopshti i fëmijëve e siguron të njëjtin ushqim për të gjithë fëmijët, por disa prej tyre kanë kërkesa tjera për shkaqe shëndetësore (psh.: alergjia).

Diskriminimi mund të bazohet në VEÇORI TË NDRYSHME PERSONALE të cilat janë reale ose vetëm supozohet se ato ekzistojnë. Veçoria personale është një shenjë që ka të bëjë me personalitetin e ndonjë personi, e të cilin ai “e ndan” me një numër më të madh ose më të vogël të njerëzve të tjerë. Veçoritë personale janë, për shembull, raca, ngjyra e lëkurës, shtetësia, përkatësia kombëtare ose origjina etnike gjuha, bindja fetare ose politike, gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual, invaliditeti, statusi martesor ose familjar, grup-mosha, anëtarësimi në organizata politike dhe në organizata të tjera etj.

Diskriminimi mund të jetë i drejtpërdrejtë ose indirect, i qëllimshëm ose i bërë nga mosnjohuria. Mund të ndodhë që qdo kush të bëjë ndonjë akt të diskriminimit, dhe që për këtë të mos jetë i vetëdijshëm.



Kush është Komisari për mbrojtjen e barazisë?

Komisari për mbrojtjen e barazisë është organ i pavarur shtetëror.

MISIONI ynë është zhdukja e secilit diskriminimi dhe kontribut në ndërtimin e shoqërisë tolerante në të cilën të gjithë i gëzojnë të drejtat e barabarta dhe kanë mundësi të barabarta.

VISIONI ynë është Serbia si shoqëri e drejtë, e hapur dhe tolerante e njerëzve të barabartë me mundësi të barabarta, në të cilën respektohet qenie të ndryshme njerëzore.

Çfarë bën Komisari për mbrojtjen e barazisë?

Komisari vepron sipas ankesave për shkak të diskriminimit, e jep MENDIMIN se a ka pasur diskriminim dhe nëse konstaton se ka pasur, e REKOMANDON diskriminusin.

Nëse diskriminuesi nuk vepron sipas rekomandimit, i bën VËREJTJE, e nëse edhe atëherë nuk vepron, e NJOJTON OPINIONIN.

Komisari mund të paraqesë DENONCIME PENALE DHE KUNDËRVAJTESE për shkak të shkeljes së ndalimit të diskriminimit.

Komisari mund të paraqesë PADI për shkak të shkeljes së ndalimit të diskriminimit, në emër të vet dhe këtë me pëlqimin dhe për llogari të personit të diskriminuar, nëse deri tani nuk ka filluar ose ka përfunduar procedura e forms së prerë para gjykatës për të njëjtën çështje.

